



VENDIM

Nr. 69 Datë 01.10.2009

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË
SHOQËRISË “GSA” SH.P.K NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT
TE KUALIFIKUAR TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a” dhe nenit 45 pikat 3, 4 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1, dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, gërma “a”, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.10.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k për licensim në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Dhe Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për license të shoqërisë “GSA” sh.p.k në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIM

Nr.68 Datë 01.10.2009

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË
SHOQËRISË “GSA” SH.P.K NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT
TE KUALIFIKUAR TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____